

V E N D I M
Nr.298, datë 2.3.1997

PËR NGARKIMIN NGA KUVENDI POPULLOR TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME DHE TË SHIK-UT PËR SHTYPJEN E
BANDAVE TË ARMATOSURA TERRORISTE

Në mbështetje të ligjit nr.8194, datë 2.3.1997 "Për gjendjen e jashtëzakonshme në rastet e cenimit të rëndë të rendit kushtetues dhe të rendit publik",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Forcat e Armatosura të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të SHIK-ut ngarkohen nga Kuvendi Popullor për shtypjen e bandave të armatosura terroriste dhe për vendosjen e rendit kushtetues e publik.

II. Për kryerjen e detyrave të mësipërme, këto forca të armatosura do të komandohen nga gjeneral Bashkim Gazidede.

III. Ky vendim hyn në fuqi më datën 2.3.1997.